



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Aleanca Kundër
Diskriminimit LGBT



VJEN PËR HERË TË PARË NË SHQIPËRI V.

(E NJOHUR MË PARË SI EVE ENSLER),

artiste dhe aktiviste feministe amerikane me famë botërore. Pjesa e saj teatrale “Monologjet e Vaginës” e shkruar në vitin 1996 u përkthye dhe u shfaq në 35 gjuhë, dhe i dha jetë Ditës V (V-Day), një lëvizje globale aktivizmi për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave në botë.

Nuk është e kollajtë ta përcaktosh V.! Ajo ka ngritur zërin, ka qenë në rradhë të parë të protestave, ka shërbyer në qendra ndihme, ka lobuar qeveri e organizma ndërkombëtarë, dhe ka shkruar pjesë teatrale, skenarë filmash, artikuj e libra mbi dhimbjet e fitoret e grupeve të ndryshme shoqërore që kanë mbijetuar shkeljen e të drejtave të tyre: që nga viktimat e padijes dhe diskriminimit që shoqëruan pandeminë e HIV/AIDS, tek gratë dhe vajzat viktimat të përdhunimit në të gjithë botën, duke përfshirë gjatë luftrave në ish-Jugosllavi në vitet 1990, e deri tek viktimat e krimeve mjedisore.

**NDAJ, MOS E HUMBISNI RASTIN TË MERRNI PJESË E TË KONTRIBUONI NË DY
AKTIVITETE TË VEÇANTA ME V.!**

ÇFARË: Shfaqja “Monologjet e Vaginës” në prani të autores V. (e njohur më parë si Eve Ensler)

KUR: E mërkurë, 22 nëntor, 2023, ora 18:30

KU: Teatri Kombëtar (ArTurbina, Tiranë)

ÇFARË: Bisedë me V. (e njohur më parë si Eve Ensler)

KUR: E enjte, 23 nëntor, 2023, ora 18:30

KU: Qendra Destil, Tiranë

Ju lutemi, konfirmoni pjesëmarrjen në të dyja aktivitetet ose në njërin prej tyre, deri në fund të ditës më 20 nëntor 2023, në adresën ilirianabasha@gmail.com ose në WhatsApp në numrin: **+355 69 850 3707**

Ju mirëpresim!